


*Gruas sime znj. Sherife
dhe bijave Florie e Lirie
dhe fëmijëve të tyre*

Autori



PARATHËNIE

Ideja për të shkruar vjersha kushtuar periudhës më të hershme të fëmijës nuk është e re për mua, por ajo u realizua që tashmë. Në të vërtetë, ndonjëra nga vjershat e kësaj përmbledhjeje që po del me titullin "**Fletë ditari rreth një motmotari**" është shkruar paralel me vjershat e përfshira në veprat: "Miklime", "Rrezet e ylberta" dhe "Me buzët në gaz", por që tashmë u përpunuan paksa dhe njëherazi u rrit ndjeshëm numri i tyre.

Krejt përmbledhja është konceptuar si një shfaqje teatrore, në të cilën personazhi kryesor i trajtimit në një familje 6 anëtarëshe, është foshnja djalë (po mund të jetë edhe vajzë) që prej momentit kur vjen në jetë dhe derisa mbush njëvjetorin. Lidhur me mirërritën e tij kujdeset tërë familja. Në këto "fletë ditari" si autore paraqitet e motra, katër-pesë vjeçe, e cila vëren, pyet por edhe e mëson vëllain se si të hedhë hapat e parë në jetë. Në këtë mision realist e ndihmon gjyshi, por nuk janë pasivë as gjyshja dhe prindërit e saj, babi dhe mamë.

Të gjitha mendimet e dëshirat e shprehura në vargje janë ngjyer ngapak me humor të lehtë dhe pothuajse asnjëherë të nxehtë. Humori dhe rrëfimet anojnë gjithnjë kah sjellja edukative e mësimore.

Me një fjalë, motivimi i këtyre vjershave është sadopak jo i karakterit informativ sa i karakterit letrar, mësimor-edukativ e zbavitës.

Sidoqoftë vjershat e kësaj përmbledheje besoj se do të jenë të mirëpritura, jo vetëm nga lexuesit e vegjël, por në radhë të parë nga prindërit, të cilët duhet t'i lexojnë për vete dhe aq më tepër për fëmijët e tyre. Për mendimin tim, assesi nuk mund të përjashtohen as lexuesit e tjerë, të cilët mund të jenë edhe pleq nga mosha, siç është edhe vetë gjyshi që paraqitet si autor real a bashkautor i ideve të së mbesës kureshtare dhe me plot fantazi.

Duke pasur parasysh faktin se, simbolikisht çdo vjershë paraqet një "fletë ditari" të rritës dhe të bëmave të motmotarit, lexuesi i nderuar dhe i apasionuar mund të vërej lehtë se shumë "fletë" i mungojnë këtij "ditari" sipas fazave të rritës, prandaj e lus të tillin që mos ta ketë rëndë dhe vetë t'i plotësojë ato "fletë", ashtu siç di dhe e ndjen vetë ai.

Suksese, pra, e çaste të këndshme!

Prishtinë, nëntor 1996 Autori

PARAQITJE PARAPRAKE

Unë jam Imja
vjet: mbi tri
s'jam aq e vogël
po shkrim nuk di

po bashkë me këtë
gjysh mahitarin
shkruamë këto vjersha
mbi motmotarin

motmotari
është im vëlla
që ka bërë
të bëma të mëdha

që prej se erdhi
e deri më sot
ka aq të mbërime
që s'kapen dot,

por ca prej tyre
filluar prej së pari
këtu janë shkruar
si "fletë ditari"

edhe nanëmadhes¹
i japim të drejtë
kur lyp hise
në disa fletë!

kurse prindërit
përveç: buzëqeshje
meritojnë dihet,
edhe peshqeshe,

se nuk është lehtë
të mbahet shtëpia,
nuk është aq lehtë
të rritet fëmija...

Po im vëllai që
bën vetëkënaqe
thua se ka mbirë
si lulja në bahçe!

s' ia var kujt
dhe s' do të dijë
sesa shumë mund
u derdh ndaj tij!

1) gjyshes

FAZA I

Lajmi se "mami e ka gjetë një vëlla te spítali" u prit paksa befasisht nga e motra, Imja, vajzushja "mbi trevjeçare", e cila shpreh habi, por edhe bën vërejtje e pyetje fillimishte lidhur me këtë, por do të jetë edhe më aktive në këtë drejtim rreth ngjarjeve që pasojnë në javët e para të jetës së bebushit, të cilin e quan Imi. E gjithë kjo atmosferë është pasqyruar në këto 14 vjersha a "fletë ditari" të këtij cikli.

ATMOSFERË

Ç' janë këto lule
në komodinë,
kush do të vijë tash
me makinë?

-Me makinë
po vjen bebushja,
ja, n' krahë tash
po e sjell nënushja.

Gëzo, lumno, pra,
ti vogla motër
se po të vjen
yt vëlla i vockël!

-Po atë, mamit,
kush ia fali,
kush ia sollë
te spitali?!

Pse thonë pëllumbi,
pse lejleku,
pse zanëmira
i artë peshku?!

-Ashtu - kështu, thonë,
po ti të më rrosh,
me moshë të gjitha
do t'i mësosh.

VËREJTUESJA

Unë jam Imja
dhe pse jam fëmijë
të gjitha gjërat
dua t'i di!

pse im vëllait
sa kafshorja
ia kanë blerë
më parë këto lodra

është kjo punë
që më bën nervoz
kur ai s'i përfill,
as s'di të loz'!?

Me të, thonë,
erdhi gazmia
me të, thonë,
u ngjall shtëpia!

Unë pak po e ndjej
atë ngjallëri,
vallë ku fshihet
kjo madhështi?!

VËREJTJE FILIMISHTE

-M' urojnë vëllain,
më vjen çudi,
pse s'ma ofrojnë
ta shohë me sy?!

Kam të drejtë
të shpreh merak,
pse e sollën
kështu "lulak"?!

-Urime, them,
por pa pyetë s' rri:
- Pse mami e solle
kaq kërthi?!

pse s' e zgjodhe
pak më të rritur,
pse s'e more
pak më të ditur?!

Kështu si qenka
s'kam si ta dua
kur ai s'mund të flasë
as të lozë me mua?!

-Kij durim, pak,
moj bijë dëshiri
se me kohë
do të gëzojë vëllamiri!

NJOHJA ME BEBËN

Pse moj mami
bebja fle
kurse mua
gjumi s'më zë?!

Zgjoje mami
ta shikoj
jam e motra
t'i tregoj!...

Po ky, mami,
rri i mërrulur
s' i çel sytë
duket i lodhur?!

-Duhet t'kesh
bijë, mirëkuptim
mbase është lodhur
n' rrugëtim!

rrugë të gjatë
i ra të kalojë
që të vijë te ne
dhe të na gëzojë!

MULE, MAMI!

Mule mami,
po vërret pa marre
ky farë "mëk-mau!"
pa e ngucë kush fare,

gojën hapka
buzët shtrënguaka,
vallë, çka dashka,
ç' dëshiruaka!?

-Po t'i hundën,
më, mos ia çik
se ky "mëk-mau"
të thotë:(u)ik, (u)ik!

bën "uik, uik", thotë:
mos më nga
se të kam motër
më ke vëlla!?



16

PËRSHËNDETJE

-Pse mamushe
kjo bebja jonë
veç hap gojën
dhe gëgë-lon!

-Me gojë hapur
shpreh ç'i do shpirti:
do pak qumësht
të nxjerrë nga thithi!

Më gëgë-të
përshëndet motrën
ndryshe s'di,
është shumë e vockël!

por s' do të vonojë
për çdo mëngjes
me "fjalë" të tjera
do të përshëndesë!

dhe nëse e mban
nën përkujdesje
do ta falë të parën
buzëqeshje:

që është në vetvete
një silyjni
në më të bukurën
mrekulli!

17

KREMTJA E PAGËZIMIT

Lum kjo ditë,
është festë e rrallë,
gëzojnë prindër
e xhaxhallarë...

gëzon tërë shtëpia
gjyshja, gjyshi,
dajat, tezet
tërë farefisi!

Shumë të ftuar
e të paftuar
erdhën sot
për të na uruar.

Gëzuar! - më thonë,
për vëllain tim
që sot do t'ia vënë
emrin përgëzim:

propozojnë për
vëllain tim:
Shkëlqim, Urim,
Fitim, Lirim
Kushtrim, Blerim...

18

Nuk di mirë
si do ta quajnë
nuk di mirë
si mund ta shkruajnë,

por për mua
ky vëllaIMI
shkurt do të quhet
vetëm IMI!

dhe ai mua
pa pëshjellime
do të më quaj
shkurt motra IME!



19

ANKESË!

- Mami u lodha
prit e prit,
Imi fare
s'po i çel sytë?!

Të gjitha sendet
duhet t'i shohë,
pa e parë motrën
s'di ta njohë?!

S'po di ç'lodër
me ia sjellë,
mbase atë llambën
si fener?!

-Jo, tash lodrat
mbajti te këndi
pas do ditësh
do t'u vijë rendi,

tashti dil, luaj,
vazhdoje jetën
deri sa IMI
ta marrë veten!

A KA BEBJA GISHTA?!

-Mami, e di,
bebja s'ka dhëmbë,
po a ka gishta
në këmbë?!

-Nesër bijo,
që me natë,
do t'ia shohim
në govatë;

a ka gishta,
a ka thonj,
a i ka të bardhë
a karabojë!

Nesër, n'se do
të më ndihmosh,
ujin për bebën
t'ma voktosh!

-Qejfashumë!
se lëng-sapun
di të hedh në ujë
dhe të bëjë shumë!

- Mbi ujë të vakët
këmbët ia qesin
sa ka gishta
e thonj ia njehim.

Pra tash shko
fli, Ime mira
se nesër në nadje
të pret detyra!

SHUARJE NGATËRRESË

-Gjyshe moj,
më ndje të lutem?
-Fol si shpejt
se tash po ngutem!

-Mamit thuaj
të më japi lejen
ta laj kukullën
bashkë me bebën,

të më lejojë Imin
ta lidh, ta zgjidh.
-Po ti vetë
thuaja më mirë!

-Unë ia thashë
po ajo s' do fare
thotë se Imit
i vijka marre!

-Mbase marre
apo zili
e paska çunin
namuslli!¹

Sidoqoftë,
dhe kjo ngatërresë,
u dashka zgjidhur
pa zhagesë!

1) të moralshëm

PAQARTËSI A SMIRË!

-Babi, babi!
-Folë, çfarë ngjau??
-Mami Imin
sot kur e lau

i tha: xhan e shpirt
më kënaqe! -
dhe e puthi në kokë
jo në faqe

e puthi lartë
në maje të kresë,
vetë e pashë
me sy, për besë,

ndërsa mua
rëndë më qortoi
pse s'di nina
t'i këndo!


-Për ninulla
pyet nënëloken¹
e unë qetashti
ta puth majëkokën,

e smirë mos mbaj,
mos u përlosh
dhe për diç zemrën
dua ta shëndosh:

1) gjyshe

beso, se mami
ashtu si unë,
Imin dhe ty
ju duam shumë...

të pandarë shqim
ju kemi në zemër,
xhan e shpirt
keni një emër!



24

ARSYETIM ME VEND

-Ime, Ime,
mori bijë
pse ke rënë
në sekëllidi?!

Pse i ke ngrënë
vetullat përpjetë
mos t'janë mbytë
xhemijat' në det?

-Gjysh, i mirë je,
tungjatjeta,
nuk kam, jo,
anije të vjetra,

po diçka tjetër
më bren përbrenda,
diçka e madhe
sa s'ta merr mendja:

më thuaj, pse Imi
ka kaq pushtet
ai tashmë doli
si despot-mbret?!

Prej se erdhi
e u fut këtu:
disiplinë
e rrebtë na u vu!

1) anijet

25

mua më thonë
mos "krrek" si pulë
ty s'po të lënë
me tymë me llullë,

majegishtash
duhet ecë ngadalë
punë shumë kryhen
pa zë, pa fjalë!

kur ai qan
brof n'këmbë mahalla (!)
për ty, mua kujt
më s'i ha palla!

-Kaq rëndë, bijë,
punët mos i kap
për këtë bindje
të drejtë nuk të jap.

S' është keq t'kemi
më shumë kujdes,
madje t'shmangim
dhe ndonjë ves:

më pak zhurmë,
duhan më pak
është më mirë
për sh'ndet, për bark!

26

Dhe ti, Ime,
e vockël kur ishe
pushtet të tillë,
më të madh e kishe!...

Për këtë punë
nuk vrënjiten vetullat,
kësaj i thonë mjaltë
për me i lye petullat!



27

GRUSHT BOKSIERI

-Mami, ky im
bullafiqi
që ishte i madh
veç sa dygishi

tash ka lëshuar
shtat me pëllëmbë
dhe më shpejt
lëvrit me këmbë

po pse i mba
grishtat sigrusht
vallë kërkuaka
ndonjë kusht

mos dorashka
të forta ding
si boksierët
që dalin në ring!

-Oh moj vërejtëse
e dalluar
grushtet shpejt kanë
për t'iu lëshuar

me ushtrime
për çdo mengjes
do ta arrijë
dhe këtë sukses!

FAZA II

Kaluan javët, madje dhe muajt e parë. E motra fillon ta dojë më shumë vëllain dhe fillon të zbulojë te ai gjëra tejet tërheqëse siç është buzëqeshja, pastaj interesimi i tij për lodra etj. Njëherazi atë do ta gëzojnë shumë variacionet e ndryshme të gjuhës së foshnjes me gaugulime të reja, por në rritën e saj do të vërej edhe ndonjë "sjellje të pa përgjegjësi"! Ç'është e vërteta temat e trajtimit në këto "fletë ditari" do të vijjnë duke u ndërlikuar, por edhe ndihma e gjyshit nuk do të mungojë që idetë dhe gjykimet e vogëlushes të shprehen sa më mirë dhe natyrshëm. Të gjitha këto mund të lexohen në këto vjersha a fletë ditari të këtij cikli.

PLOTËSIMI

-Shpejt rend vala
poshtë në lumë
shpejt ec koha
kur të keshë punë;

por më shpejt
dhe me lezet
ecën koha
kur të keshë shëndet!

-Mirë e the, gjysh
nuk e teprove,
por diçka
mbase harrove:

Rritet shpejt
dhe gëzon tërë votra
vëllanë e vet
kur e mëkon motra!

-Falemnderit
që më plotësove
dhe pse veten
cazë e lavdërove!

BUZËQESHJA SIHARIQ

Pse moj gjyshe
s'po më dëgjon,
unë po të flas
ti s'më shikon!?

Sot ditëherët
posa u zgjova
dhe kah Imi
sytë i lëshova:

pashë një dritë
si vetë hyjnia
dhe vërtet
ngjau mrekuillia:

pa e çik n' mjekërr
as pas veshi,
më beso, Imi
më buzëqeshi!

Më buzëqeshi
me ëmbëlsi,
pasha mamin,
pasha ty!

Në brendi thellë
ndjej lumturi,
s'di ta shpreh?!...
më mëso pak ti?!

DREJTSHIKIMI I IMIT

-Gjyshi, ta them,
një befasi,
ti s' më bëson
të njoh unë ty!

prandaj eja
vetë të bindesh
s' ke nevojë
me mua t' grindesh:

ja, shih Imin
si këqyr drejt
si i ka syçkat
shihja vetë!

rrumbullak
si kokrra rrushi,
një sypëllumb
i shkundur pushi!

Eja bindu
dhe mos druaj
më trego fjalët
si ta përshkruaj...

ai prej nesh
s' frikohet, jo,
mua dhe ty
shumë shumë na do

na do shumë shumë
dhe na njuh qartë,
kështu më tha mami,
është e saktë?!

SILLNI RRAKATAQE!

Rrakataqet
shpejt i sillni,
jo për mua
po i kërkon Imi!

Sot kur theva
një shkoph të thatë
ai më ndoqi
dëshirëzjarrtë,

sytë s'i ndante
drejt zhurmimës
dhepe rrinte
në kokërr t'shpinës,

prandaj sillnia
rrakataqet
le të lozë vetë
vetë le të kënaqet!

MOSMARRËVESHJE

Ditë më ditë
e java - java
shkuan do muaj
si badihava!

- Jo, këta muaj
gjysh, s'ikën kot
prandaj çka the
s'ta pranoj dot!

Është kjo kohë
kur Imi vëlla
erdhi te ne
na shtoi sevda!

a s'po të kujtohet:
i vockël - llullë,
tashmë i madhuar
shtatngjesh si burrë!

Sot kur mori mami
në govatë me e la
i ndriste koka lartë
si ballnik në kala!

-Krejt çka the, moj bijë
e ke fort me vend
unë n' mend pata
një tjetër send:

kush ka punë
dhe rri kotsëkoti,
badihava, thonë,
zi i shkon moti!

IMI HALITAN!

Sa mirë Imi
shpejt po rritet
po ka zënë tash
të halitet...

shtiret, gjoja s'di,
ai zotia e tij,
dhe bën do sjellje
pa përgjegjësi:

sa e mori sot
babi në prehër
Imi ia bëri
një shenjë pa "emër"!

kur unë u përpoqa
ta përqafoj
ai për bistekësh
fort më shtrëngoi!

rrëmbu nga gjyshi
qystek e orë
dhe deshi të dyja
t'i fusë në gojë!

kurse gjyshes,
hiq pa mahi,
deshi gishtin
t'ia fusë në sy!

...Për këso lëshimesh,
për këto gafe
lyp ndëshkim
jo falje, llafë!

TASH QË U RRI!

Tash që u rrit
dhe lëshoi shtat
halitani
s' do të rrijë në shtrat;

s' duron më
as napë në fytyrë
as këmbeduart
me ia lidhë;

do të shetisë
veç të shetisë
do ta shohë
çdo kënd të shtëpisë;

bën me dorë
me dalë në ajri
s' pyet për kohë
as për mundësi!

- Më ngadalë
more princ dai
veç ty s't' kemi
në këtë nahi!¹

t'na urdhërosh ne
s' ka kuptim
kështu si sillesh
i thonë lazdrim!

1) krahinë

36

KËSHILLA E MOTRËS

Imi, zemra,
ndëgjo mirë,
ta jep motra
një këshillë:

prizën në mur
kurrë mos e prek
se është rrymë
gishtin ta djeg!

as gjilpërë
mos kap me dorë
as këpuca
mos fut në gojë

në gojë fut
veç gjëra të mira
ëmbëlsira
keks-gurabia!



37

GAUGULIMË!

Imi u zgjua
vështroi përreth
diçka duket
s'qenka në qejf!

sepse nisi
të bëjë: *ua, ua!*
-Mulni shihnje
çfarë të mirën ka!?

-S'ka gjë të madhe,
me marrë mërzë,
kërkon mamin
ta mëkojë në gj!



38

ALARMUESI

-*Au, au!*
Çfarë po ndodh kështu?
-Alarm, i vogël
që s' trazon shumë
do të thotë: zhgjhoni
mos rri ni n' gjumë!

Mos rrini gjumshëm,
këqyrni punoni
por dhe alarmuesin
mos e harroni!

Mos e harroni
këtë halitan
që gjithmonë mëmin
do ta ketë pranë,

por llafë të thata
dhe këngëtime
lyp edhe nga gjyshja
dhe motra lme,

por s' duroi gjyshi
ia tha do fjalë:
-Po kush na qenke
ti more djalë
që do tërë shpija
të sillen vërdallë!

Mos u bën si biramel
me na qitë pengesa
gjej punë vetes sate
pa na nxjerr' ngatërresa!

39

ZHURMAÇI!

-Ua, ua, au au!
-Imi mos bën xhurllti!
-Ua, ua, au au!
-Imi, Imi, më urtë rri!

Më urtë rri
mos e tepro,
se kështu as mëmi
nuk të do!

E di mirë
se kur të vijë koha
do të ushqej
me qumësht e molla!

Mos harro
sa pive sot
dy gota tambël
mbushur përplot!

tashti qetësohu,
s'je në zor gjithaq,
mos zhurmo sitepër
se të quaj zhurmaç!

kupto se dhëmbi
dhe kaq me të dalë
nuk të ushqej ndryshe
veç me orar!

unë mbaj komandën
pe nuk lëshoj dot
nuk e prish rregullin
pse ti zhurmon kot!

40

NË SHETITJE

-Gël, gël, gël!
-Pse gël'gëlon,
kush po e mbrec
kush po e xiglon?

-Jo askush
përveç rrezes,
jo kurrkush
përveç erës!

rrezja i preku
faqet ëmbël,
era n' doçka
i soll një pendël!

Rrezja, pendla
e ngazëlluan
edhe motra
me të kah luan!

Ajo ndaj Imit
ka shumë kujdesë
që gjatë shetitjes
mos të ketë pengesë...

ja, hije më hije
po i shtyn karrocën
kush për këtë vepër
s' e lavdon gocën?!

41

ÇFARË I NGJAU?

Çfarë ka Imi,
vallë, ç'po ngjet?
papandehur
vallë, pse vrret?!

-Uak, uak
uëk, uëk!
-Këqyrni mirë,
mos është për mjek?!

-Piu, piu!
-S' pushon vaji,
pyetni mamën
çfarë ka djali?!

-Çfarë ka ngjarë
po jua them fill
sot Im çuni
s' veptoi mirë

Pshesh me grusht
deshi të fusë në gojë
porse e derdhi
s'kish përvojë.

Dhe me grusht
e mori nga toka
deshi t' bëjë punë
që s' ta kap koka!

përshesh me dhe
deshi të hajë
kur s' e lashë
filloi të qajë!

42

IMI DHE ZOGAT

Ulur mbi postajë
në jastëk mbështetur
Imit papandehur
i vjen një e qeshur,

vallë çfarë e frymëzoi,
gazin kush ia nxori
mbase ai gjelushi
që këngës ia mori;

mbase ajo sorra
që në gardh vështrioi,
mbase dallëndyshja
n'ajri kah fluturoi!

Si duket do zoga
atë e ngazëlluan
që fare pa u trembur
Imit iu afruan

iu afruan si tepër
tue qokë rreth e qark
ia mblidhnin therimet
që i kishte n' gjoks e n' bark!

Imi ish në të qeshur.
kur e hetoi motra
-Ish-ni!, mori pula,
ishni, mori zoga!

Ishni mori zoga
dhe ti pupëlgjel
mos e ngani çunin
s' është ai kokërr mel!

43

GJUHË SHËNJTËRORE

Gjysh, që të thonë,
ty: poliglotës¹
sepse i njeh
ca gjuhë të botës

po si flet Imi
a ke dëgjuar
ç'fare gjuhe i thonë
si është emnuar!

mirë dëgjoje
dhe vlerësoje:

i al il, a il
aa, ël ël:
ba ba ba
e mël gël mël!

mël gël gël
e la la la
dël dël dël
e na na na

au, au
arllaj arllaj
ua, ua
dhe aj aj aj!...

1) poliglot - njohës i shumë gjuhëve.

çfarë gjuhe, gjysh,
mund t'i thonë kësaj
herë gazmore
herë pak si n'vaj!

-Është gjuhë gazi,
mbesëmira,
gjuhë ylberi
me shumë ngjyra

është gjuhë jete
plot shëndet
gjuhë muzike
me lezet t'vet,

gjuhë e rrezes,
gjuhë shenjtërore,
gjuhë vullneti
gjuhë foshnjore!

FAZA III

Koha kalon dhe Imi çan përpara, tashiti ai bën zbulimin e madh: mund të lëvizë vetë nga vendi, mund të zhagitet, madje gaugulimet i shton deri sa përpiqet të shqiptojë ndonjë gjysmë fjale a ndonjë rrokje shenjzuese. Tashiti e motra dhe të tjerët kanë më shumë punë rreth tij e lidhur me të. Ndërkohë del e nevojshme që të ndërmerret edhe ndonjë "masë mbrojtëse" në mënyrë që jo vetëm ai mos të pësojë vetë, por edhe mos të pësojnë të tjerët nga "veprat e tij naive a të qëllimshme" (!) siç janë: thyerja e enëve, prishja e paqetës së cigareve të gjyshit, të ulurit në tepsinë me ëmbëlsira e shumë e shumë të bëma të tjera. Sipas rastit tashiti Imja i jep edhe këshilla, por edhe e paralajmëron për shkelje të ndryshme të rregullave të rendit shtëpiak, por edhe të etikës përgjithësisht. Me një fjalë ajo e mëson, por edhe e qorton. Për më shumë hollësi le të shfletohen "fletët e ditarit" të këtij cikli vjershash.

ZHAGAÇI

-Mami, ku e ke lënë
voglushin Im?
-Në dhomë të pritjes
mbi qilim.

-Jo moj ai tash
sa doli në kuzhinë
dhe ja si rri strukur
nën tavolinë!

-Ç'je kah thua,
e çoj dikush!?
-Jo ai shkoi vetë
s' ndihmoi kush!

ecka zhagaz,
ti parë s'e ke,
kambadoras:
urith mbi dhe!

-Ta shënojmë datën
për këtë të bardhë ditë
lum ne fatbardhët
çka kemi pritë!

IMI HA PËRSHESH

Mami dërgoi Imin
te dardha, nën hije
dhe ia shtroi mos të ftohet
dy palë batanije,

n' teferiq ia solli
dhe pjatën me përshesh
kish ndërmend djalushin
ta ushqejë me kujdes,

mirëpo der'sa vajti
të sjellë dhe pak ujë
djali mor sahanin
dhe bëri rrokopujë:

lugën e la anash
ia filloi me grushta
sa e sillte te goja
aq në gjoks kah gusha;

herë i jepte faqes,
herë ballit kah hunda
u bë si palaço
me përqeshë dhe pula!

Kur e pa kështu mami
nuk e qortoi shumë
- Është uritur djali
fajet i kam unë!

Mbase kishte mundë
më pedant të jetë
po dhe kjo përvojë
le t'i ndihë për jetë.

TESTIMI

Imit ia ofrova
një album me ngjyra
me kafshë të llojllojshme
që po i rrit natyra.

I thash cilën do
preke pak me gisht,
zgjidh po deshe qengjin
o dacin pa bish!

në daç një majmun
tigra a luanë,
po deshe lopën
që ka viçin pranë;

prek në do gjirafën
a deven me dygunga
apo zgjidh nga shpezët
ca laroshë pëllumba?!...

...luta, luta Imin
ai kund nuk ndaloi
mbase thashë, e mjera,
çka i thashë, s'më kuptoi!

por jo, ai kuptonte,
dhe për befasi
gishiti i tij tregues
shkoi në Australi!

Atje kish hetuar
një nënë-këngure
që të voglin e mbante
në sipërparcë lëkure!

Për të na bindur
se e kish njëmend
shpejt iku tek mami
dhe aty zuri vend!

iu struk asaj në prehër
si këngurthi në strajcë
donte, s' di çfarë donte,
t'i varej në përparcë!



ORA TE VESHI

Se sa lehtë
fitohet vesi
dëshmon Imi
me orë veshi!

Gjyshi ashtu
si për mahi
ia vuri orën
te veshi i tij,

po tashti Imi
të qetësohet s'dashka
pa i varë te veshi
orën: *tika taka!*

-More, Im lazdrani,
i thotë e motra, -
mos kërkto tepër
çka nuk e qas bota!

E di, ka orëdore
ka dhe orëxhepi
orë muri të ndryshme
por jo dhe orë veshi!

prandaj, ti zemra,
më mos u lazdro
harroje atë orë veshi
kurrë mos e kërkto!

IMI SHITIRAN

Pse Imi po shtiresh,
gjoja se nuk di,
se s'bën të përllomesh,
as të luajsh me hi,

pa u zie mirë kokrrat
nuk hahet fasuli;
pa u përzie me gjalpë
nuk ndriqet as qulli,

madje as spinaqi,
edhe në qoftë i grirë
ti mbase mund ta hashë
po s'ka shije të mirë!

Ndoshta ti lakmon,
ta hashë si "Popaja"¹
që me sherritë e tija
qeshin krejt dynjaja!

ai bën si nuk bëhet
kupto, si në përallë,
e ne e hamë n' byrekë
të zier, jo të gjallë!

1) Popaja - personazhi i filmave vizatimorë.

ZHAGAÇI NË ENËTORE

-*Rambabamb,*
pse bën tepsia?
dang dang ting
ndihet kusia

cingër pingër
pse u thye gota
duke u ndarë
në pesë-gjashtë copa;

rrokotel
pse u soll filxhani,
ç'është kjo plojë
pse u bë danami!

-Kush e bëri
gjithë këtë kërdi?
-Mbase macja
kah gjuan minj!

-Jo këtë e bëri
Im zhagaçi
dhe buzëqesh
i qetë shkattraçi!

madje andenaj
s' do të largohet,
thua se është vendi
ku të argëtohet!

-Mulni shpejt
andej ta heqim
dhe ngapak
shpinën t'ia ndreqim!

-Jo, thotë, gjyshi,
nuk bën me rrahë
faj ka dera
kraha - kraha!

tjera herë
dyert të mbyllen
dhe dollapet
qelë mos të lihen!



MASA MBROJTËSE

Gjyshi, të lutem
mos lë gjithkund
paqetë cigaresh
se të vënë në lum!

se Im zhagaçi,
trazovaç me zë,
t'i prish cigaret
një nga një!

Dhe diçka, gjysh,
a ke menduar
prej zhagaçit
si për të shpëtuar!

-Veç kujdesit
që duhet rritur
dhe një punë
duhet goditur:

t'ia vëmë Imi
në qafë një zile
kahdo që të shkojë
ta marrim në dije!

Ndryshe veç
me e thirrë pushtetin:
me mbajtë nën roje,
këtë Im sherrretin!

KARROCA FRIKËLORE¹

Çka ka Imi
gjysh s'ka bota:
rotullak
kulltuk me rota:

FRIKËLOREN
si veturë
por pa motor
pa tastaturë

që e nget vetë
pa dorë me këmbë
andej për të dalë
e ka shumë rëndë!

Kështu e kanë futur
në rreth-karrocë
kah s' mund të dalë
der'sa t' fitojë forcë!

të forcojë këmbët
dhe të mbledhë mend
jo më t'futet skutash
ashtu vendpavend!

*1) frikëlore - qerthull për të mësuar
fëmijën të rrijë në këmbë.*

ME KRYE NË TEPSE

Mami jonë,
he i prift e mira,
dje gatoi
ca ëmbëlsira.

Imi i vogël
e shikonte
dhe gatesat
ia dëshironte,

por kjo mami,
s'ia vari veshin!
-Prit më vonë, tha,
sa t' pijë shërbetin!

dhe tepsinë
ashtu të ngrohët
e çoi n'dhomë tjetër
ku mban më ftohët

dhe e vendosi
kah dritarja
duke i vënë si anash
një çarçaf me lara,

po kishte harruar
derën me mbyllë
dhe këtë lëshim Imi
e vëren fort mirë!

kështu zhagaçi
këmbadorë
ngadalë fshehtas
hyn në dhomë!

dhe çfarë bën,
ma mirë mos të flasim,
pasi ai s'dinte,
të heqë çarçafin!...

por mbi të hipur
ai nuk vonon
tri - katër copa
i përgjysmon

por në zhagallim
mbi çarçafin e ri
rrëshqet padashtas bje
me krye në tepsi!

qau!... e kur e pa mami
veçsa s'u shastris
- Gjithë atë mund, majmuni,
krejt ma paska prishë?!

Gjyshja me të shpejtë
e nxori jashtë çunin
- S'paska bërë shumë keq
e paska tremb pëllumbin!

Po s'di, mëllefi mamit
si mund t'i kalojë
kur ka me i la patjetër
çarçafin me shtrojë!?

Por edhe gjyshja
me fjalë po e vret:
- Mos e nga djalushin
fajin e ke vet?!

- S'është e kotë, moj nuse,
këshilla që shpesh thuhet:
*kujdes se prej macës
mishi përherë ruhet!*



60

IMI DHE PINGUINI

-A dini,
jo, s' e dini
çfarë sot
na kërkoi Imi !?

Posa u krye filmi
në televizor
ai thoshte -*Ama, ama!*
edhe bënte shenjë me dorë;

-*Ama ina! Ina ama!*
thujse qante me lot
në zor ra krejt shtëpia:
çfarë kërkuaa sot!

Mbase kërkon zoga,
mbase një qenush
që e shoqëruan filmin
bashkë me një arush?!

-Jo, mor jo, s'e dini -
tregon motra vetë -
kërkon pinguinin
që e ka parë në bregdet!

që i ka parë larg larg
atje në Antarktik
kujton se është afër
si pula në furrik!

61

Tregoi gjysh të lutem
pinguina te ne s'ka
për dëshira të tilla
thonë: zogu në hava!

-Hej mor Imi Gjyshit
tjetër është dëshira
e mundësia tjetër
mirë e ka mbesëmira!



62

LOJA ME GISHTA

Imja jonë
gati pesëvejeçe
meritoi sot
notën dhjetëshe

se e mësoi Imin
me durim, pa bujë
të leviz gishtat
dhe si t'i quaj

-Lëviz secilin
sipas emrit që ka
ashtu siç të mësova
o Imi vëlla!

ky *treguesi,*
gishti i unazës,
gishti i gjatë,
i vogli i nanës

ky *gishti i madh*
edhe pse i ndarë
të gjithë i ndihmon
për punë të mbarë!

lëviz *të djathtit*
një dorë: **sivëllezër** pesë
lëviz *të majtit:*
po aq **simotra** pesë

63

vazhdimisht lëvizi
kështu pa pritesë
vëllezërit me motrat
puqi me kujdesë

puqe të madhin me të madhen,
të gjatin me të gjaten,
mbaje gjithnjë radhën;
beri t' gjithë t'përfaqen!

ushtroje, pra, vëlla lojën:
vëlla/motër më shpesh
mrekullinë e gishtave
më qartë do ta keshë!

Cil mbyll grushtat shpesh
pëllëmben hap e çhap
mbaj mend se si quhen
gishtat në shuplakë!



64

IMI DHE ISH-JA!

Imi kapsimiti,
Imi kapsomuni,
di çka është qyteti
di çfarë ka katundi;

di si duket pula,
di si duket gjeli,
por s' e di si quhen
as njëri as tjetri;

për të gjitha kish mësuar
vetëm fjalën *ISH*
kështu gjyshja i trembëte
kur këtë n' duar e kish,

prandaj edhe në ekran
kur do pula u duken
-ISH, -ISH! - klithi drojshëm,
s' mundi ta fshehë tuten!

qeshën të gjithë me të,
por jo dhe vetë loçka
se n'shpiert i kallte datën
gjeli me ato kloçka!

Nga gjeli e nga pulat
Imi kish marrë tremë
se i kishin marrë nga dora
bukën lyer me xhem!

65

Por tash motra Ime
mori të madh zotim
që vëllain ta shoqërojë
dhe ta bëjë më trim

-Kapsomuni i motrës
more kapsimit
sa ta keshë ti motrën
hiq mos u mërzit!

Më gjeli as pulat
s' mund ta marrin bukën
se në atyre në palcë
do t'ua fusim tutën!

Si t'na shohin bashkë
ato, shkurt e trup,
pa ua treguar shkopin
do të zmbrapen me turp!



66

FAZA IV

Faza e pjekurisë së njëvjeçarit arrin kur fillon të hedhë hapat e parë, njëherë me cacërime e pastaj me hapa më të sigurtë si dhe me vrapim të njëmendë "maratonik" prej disa hapash. Në këto kushte del sheshit edhe veprimtaria e llojllojshme, qoftë e vetë Imi, por edhe e së motrës, e cila tashit edhe vetë sapo ka shkelur në vitin e pestë të jetës. Tashit ajo si mësuese jo vetëm e këshillon Imin, por edhe e qorton për çdo shkelje të etikës. Për ndonjë "gaf të qëllimit"(!), madje edhe do ta përqeshë.

67

CACËRIME

Imi Dada
ec si Baca
ec si Baca
caca, caca!

Ec dhe mbaje
drejtpeshimin
ja kështu motra
e do trimin!

Ndërroji dy hapa
e bëj pushim,
punët s'kryhen
me ngulshim

dhe nëse rrëzohesh
rrambabumb!
mos u step
shkoi punës në fund,

pa përpjekje
pa zell të madh
asnjë arë
s' thuret me gardh!

kështu thotë gjyshi,
fjalë të vërteta,
kështu mëson puna,
kështu mëson jeta!

68

QARAMANI

Një ditë vere
kah mesdita
shkuan në plazh
prindja dhe Imja

Edhe Imi
veshë në kostum
është më ta
i gëzuar shumë!

Imi kënaqej
kah vështronte
të prekë ujin
e dëshironte

po për të hyrë
dëshirë nuk kishte
nga krahët e babit
s' desh' të zbriste

e do stërpika
kur i ranë në trup
reangoi keq
qau, sa turp!

-Pse more Im
po bën poterë
kush nuk do
të lahet në verë!

69

pse ti kështu
pa hak gajas
e sheh motrën
e ke pas,

e sheh motrën
si mëson not
dhe syri fare
nuk i lot

e t'i përloshesh
s' rri nën hije
po dhe këtu gëlthet
pa shkak fije!



70

DITË ME DITË

Ditë më ditë
e java java
rritet çuni
çan përpara

java, java
muaj më muaj
fshihet gruri,
kashtat duaj;

piqen mollët,
dardhat, rrushi,
si më i miri
ec Imushi;

ec Imushi
nëpër livadh
s'e ndal gjë
as shteku n'gardh!

Por kur shkoi
atje buzë përroi
i rrëshqiti këmba
pak e pësoi:

këmbë e brekë,
ngapak i çulli
po qau me zë,
s' u përmbajt burri!

71

GJYSHJA FALLXHESHË

Gjyshja si fallxhore
ka të mirë metodë
mos ta lërë kurrë Imin
të qajë ashtu më kot!

-Në vend se të qashë,
shqiptoji këto zanore
vajin ktheje në këngë
edhe në paç shumë zore!

qaj këndo, pra shqim,
me *ii* me *y*,
atëherë të thotë gjyshja:
lumja unë për ty!

këndo e qaj *yy*,
qesh e qaj me *!*!
shiko, pëllumbi i bardhë
po fluturon në ajri!

qaj këndo *ee*
këndo e qesh me *ë*
ëndrra t'vjen me lule
kur gjumi të zë!

këndo qaj *ëë*
qaj e qesh me *e*
të shoh je rritur sot
shumë më shumë se dje!

këndo e qaj *uu*
qesh e këndo me *o*
vallë më shumë se gjyshja
motra ty të do?!

qaji e qesh *aa*,
qysh po të mëson Lokja
qeshë e këndo si të duash
qysh ta do vetë loçka!

qaji dhe qeshë po deshe,
por në shumë mënyra
se të vijnë shqim ëndrrat
ngjyra, ngjyra të mira!



IMI E BANANA

Imi, Imi, të therret nana
të ka blerë babi banana!

Këndon e "flet" Imi:
baba nana!
dhe herë-herë
shqipton: *banana!*

Imi qëndron shpesh
ashtu sikrahëhapur
prindërit me radhë
duke i përqaful!

Herë duke qafë njërin
herë duke qafë tjetrin
lodhet ngapak djali:
po ata zëshëm qeshin!

...Porse prindërit sot
u zunë si në shaka kot
në sprovë djalin e vunë:
hata, të madhe shumë!

-Cilin nga prindët
Imi e do më fort
atij së pari falja:
një përqafulim të ngrohtë!

..Krahëhapët pret Mami;
krahët shtrin Babushi
presim cilin së pari
do ta qafë Imushi!?

Çuni mes dy zjarresh
vallë, si do t'ia dalë,
Babin apo Mamin
cilin të qafë më parë?!

Por jo, mirë u gjind,
s' doli i hutuar
i shikoi të dytë
gjithnjë i gëzuar;

shqiptoi: *BAB'NANA*
dy emra si një fjalë
dhe u kthye kah dera
mbase jashtë me dalë?!

por jo jashtë nuk doli
as s'u kthye kah *bab'nana*
por shkoi drejt te këndi
ku kishin lënë banana:

Banana, banana!
kthithi me ëmbëlsi
dhe kapi ndër duar
jo më pak se tri!

mbeten të gjithë hutuar,
për këtë pamje të rrallë
por gjyshi me romuze
ua tha *bum* në ballë:

-Më i mençëm doli nipi
në këtë sprovë axhamish
kurrë mos luani lojna
që ju ndajnë më dysh!

Imi bashkë me gjyshen
të gjithë i qerasi
dhe në shpi si ngahera
sërisht u kthye gazi!



BLLË-TË E IMIT

Imi baltën
e quan *bllë*,
bllë e quan
psheshin me dhe

bllë e quan
çdo gjë të ndytë
edhe ujin n'legen
pasi i lan sytë;

bllë e quan
dhe dheun në saksi
dhepse lulen
e ka lakmi,

por një herë
ai gaboi rëndë
bllë i tha hallvës
ende pa ngrënë,

po kur shijen
ia provoi
me *bllë* s'mundi
ta kërkojë!

po me: -*Ama*,
milë, po,po!
jo bllë, bllë,
po ohoho!

FTESË SPORTISTI

Imi eja t'bëjmë
fizkulturë
të mësoj të lëvizësh
këmbë e duar,

këmbë e duar
dhe dejt e qafës
para, mbrapa,
majtas, djathtas;

aerobike,
bëjmë balet
si më të shkathët
në qytet,

se pa mësim
e pa ushtrime
s'mund të bësh salto
e rrotullime;

kush ushtron,
dëgjomë ti mua,
më pak vritet
kur të zëjë në thua!

MËSIM VIZATIMI

Imi eja,
të mëson motra:
të vizatosh
çka ta do loçka.

Ja, shih lapsat
ngjyer me bojë,
mos gabo
me i futë në gojë;

tërhiq vijat
në letër lehtë
poshtë lart anash
jo me të shpejtë!

bëj një pemë
ja kështu si unë
me trup të hollë
jo me degë shumë;

me degë shumë
fryma ta shkulë,
po deshe vëri
dhe ndonjë lulë

dhe një këshillë
të mirë mbaje mend:
gjithkund punët
shkojnë me rend:

lule e fryt
në një pikturë
vëllai i motrës
mos vër kurrë,

se lulja fryti
bashkë s' u qaskan
se nga lulet
frytet dalkan!

Ruaju pra Imi
mos bën gafe
se t' përqeshë gjyshja
në shtatë bajraqe!



80

QORTIM MOTROR

Pse mor Im,
Imi i motrës,
pse po bëhesh
gaz i botës!

A t'kam thënë
mor Im mistreci
se n' degë të mollës
s'rritet speci

as domatja
patëllxhani,
kastravec
as bostani!

Janë perime
rriten në ara
jo ndër dru
si molla, dardha!

mos bën *mëk*
as *gëk* mos bën
krejt këto gjyshja
m'i ka thënë

dhe vetë i pashë
në atë pikturë
që ke dashtë
me varë në mur!

S'je i vogël tash
lum motra,
mëso më mirë
mos t'qeshin bota!

81

KICAT KICILOJNË

Çka ka Imi
që nuk zë vend
përpëlitet
dhe fort ngarend

nganjëherë gishtin
ven në nofulla
thue se mbërtyp
kore të forta!

-Kicat si duket
e kicëlojnë
ngadalë dudat
po ia shpojnë

dhe pse del dhëmbi
bardh si orizi
ai mund të të therë
sikur murrizi!

Prandaj mami
gjinjtë t'i mbrosh
se nga kici i Imit
mos ta pësosh!

82

-Tash këto ditë
kicat duke i dalë
duket IMI
shumë më i gjallë

shumë i gjallë
dhe më livritç
por kjo mos
t'ju trazojë hiq!

se kështu djali
pas pak, si bota,
do të hajë mish
dhe kore të forta.



83

IM MARATONI

Im sot u bërë
simaraton,
mjaft mirë po ecën
shpejt po vrapon!

por sa u pëpoqëm
të gjithë në shtëpi
që të mësosh suksesshëm
ti s' di sa e di?

Pak të ka mbajtë
rreth-rrotullaku
më shumë gjyshja
edhe gjyshplaku ...

njëherë të mbanin
me dy duar
pastaj me një,
me kujdes të shtuar.

Por prejse u shpik:
shalli nën sjetull,
të shpëtuan hundbuzët,
balli me vetull!

dhe kur kështu mësove
mirë drejtpeshimin
thanë simaraton
e kem' bërë Imin:

vrapues të fortë
si në kohë të vjetra
kur me hap mateshin
shumë kilometra!

84

KAFSHËT DHE SHPEZËT

N' lojë të gjyshes:
Fluturon! fluturon!
pse ti Im vëllai
gjithë po gabon!?

nuk është zor
të mbahet mend
gishtit çohet
veç për shpend!

gishtit s' çohet
hiç për kafshë
se ato qëndrojnë
në tokë, rrafsh!

dhe diçka motra
me ta ngulitë
në lojë të gjyshes
mos me lajthitë:

kush ka sqep
dhe vezë vezon
është pra shpend
që fluturon

ndërsa kafshët
që s' fluturojnë
me qumësht të vegjlit
i mëkojnë!

85

kur të thotë gjyshja
fluturon lopa!
ti mos e ço gishtin,
të pastë motra!

e kur thotë
fluturon shota!
çoje gishtin,
të mëson motra;

mos e ço për:
fluturon dashi!
po çoje kur thotë
fluturon larashi!

Kujto sqepin dhe
dhembët e mprehtë
shpendë e kafshë
i ndan më lehtë!



86

NGJARJA NË PIKNIK

Gjyshi, ndalu,
sot luaj "i parë",
dëgjjo Imit
ç'i ka ngjarë:

ndalë n' piknik
askund nuk kishte,
sikur kalë
shkopin e ngiste

vrap kah pylli,
vrap kah përroi
por as shportbukën
s'e harroi:

krofne, kifle,
torte, keks
fuste n' bark
si barrët n'thes!

pastaj zhibiu
dy gota kos
edhe qumështin
në termos

e...(!) kur diç
i trazoi barkun
me zë e lypë
oturakun

87

-Dua, ama,
otul(r)ak!
sytë i çonte
rreth e qark!

Derisa mëmi
e çoi pas lisi
duket "vakia"
më këmbë i krisi!

-Qenka ngjarje
me qeshë me zë
pa ngucë Imin
s' do ta lë

dua t'i them
o grykë pa fund
oturak
s'lypet gjithkund

Vërtet, pas pësimit
del mësim,
por dhe ju, bijë,
ishit n' gabim

se n'ato punë
që s'janë holl provuar
përkujdesja
duhet shtuar.

VESI PËR DËNIM

Imi, je bërë,
i pa marrë vesh
ke shkyer librat
dhe buzëqesh

duhet të qash
dhe të vijë marre
s' prishet libri
si mos t'ish fare!

libri i mirë
me fotografi
ke vënë re
të kënaq dhe ty,

largo vesin
mos gris më libra
se ndryshe
të dënon ligja

i them mamit
mos të ledhatojë!
i them babit
të të ndëshkojë

edhe gjyshit
bashkë me gjyshe
që ndaj teje
të sillen ndryshe!

Kujdes të lutem,
mos bën gabime
se vesi hiqet
dhe me ndëshkime!



BABI S' ËSHTË TY-TY!

-Babi a po të vjen mërzi
që Imi të ka quajtur TYTY?
Sot kur të pa në oborr
bëri TYTY dha shenjë me dorë!

Me veturë ai po të njëjson
pse t'lëndon, kështu, s'e kupton!
po ti, në atë emër mos iu përgjigj,
fjalën TYTY mos ia përligj!

-Dhe unë inatçe do t'i flas
afër vetes s' do ta qas,
kam hak ta quaj Im përseshi
madje mund ta kap për veshi!

-Jo, kështu babi, ti mos bën,
dëmin mos e mbyll me dëm,
po kur të vozitësh me veturë
pa mua atë mos e merr kurrë

se unë atë dua ta mësoj,
gabimin Imi t'ia përmirësoj
t'i them se Babi nuk është TYTY
po mbase vetura ku shetit ti!

NË PRAG TË NJËVJETORIT

Sihariq, Imi,
sa u qit torta
për festë nesër
është ftuar bota!

njëvjetorin
kah ta krentojmë
të gjithë do të lozim
do të gazmojmë...

dhe ti ta dish
ke për detyrë
të përshëndesësh
si është më mirë!

po t' i kujtoj tash
do fjalë të lehta:
miqve u thuhet:
tungjatjeta!

*mirëdita,
mirësevini,
mirëqofshi,
mirëserrini!*

kurse qiriun,
ngulë në tortë,
kur të thonë, fike
me frymë t' fortë!

dhe n' vete shpreh
një të fshehtë dëshirë
më të shtrenjten,
më të mirë!

kur të thonë
me fat e jetë të gjatë
ngritu në këmbë
pa përgjëratë...

FALEMINDERIT
thuaje sh lirë
*Ja - thuj - torta,
ju bëftë mirë!*

dhe kur të shkepen
sërish përshëndet:
faleminderit
për solemnitet!

*mirëupafshim,
udhambarë,
me t' mirë ua ktheshim
shpejt sa më parë!*

por kurora
e kësaj feste
është të qëndrosh
shqim me buzëqeshje!

FJALË ME PESHË

-Gjysh a qan
krejt shtëpia
kur bëjnë zhurme
kah luajnë fëmija?

-Jo, moj bijë,
qan çdo shtëpi
kur s' ka pleq
e s' ka fëmijë

s' ka mallkim
më të madh e të zi
se me mbetë shpija
pa fëmijë...

Ku ka pleq,
thonë, ka urti,
ku ka fëmijë
ka ardhmëri!

Nga urtia
e ardhmëria
vjen e mbarë
trashëgimia!

-Fjala jote, gjysh,
vulë me peshë
do të shenjëzohet
thellë në kujtesë!

Në atë kujtesën
e shenjtërisë
brenda shtyllës
së historisë!

PËRMBAJTJA

Parathënie,7
Paraqitje paraprake,9

Faza I

Atmosferë,12
Vërejtuesja ,13
Vërejtje fillimishte,14
Njohja me bebsën ,15
Mule, mami!,16
Përshëndetje ,17
Krenjtja e pagëzimit,18
Ankesë ,20
A ka bebja gishta?,21
Shuarje ngatërrese ,22
Paqartësi e sinurë ,23
Arsyetim me vend ,25
Grusht bokleri ,28

Faza II

Plotësimi,30
Buzëqeshja sihariq,31
Drejtshtikimi i Imit,32
Sillni rrakataqe!,33
Mosmarëveshje ,34
Im halitani ,35
Tash që u rrite ,36
Këshilla e motës ,37
Gagulime ,38
Alarmuesi ,39
Zhurmaçi ,40
Në shetitje ,41
Çfarë ngjau?,42
Imi dhe zogat ,43
Gjuhë shenjtërore,44

Faza III

Zhagaçi,48
Imi ha përshesh,49
Testimi ,50
Ora te veshi,52
Imi shitiran ,53
Zhagaçi në enëtore,54
Masa mbrojtëse ,56
Karroca rrotullore ,57
Me krye në tepsi ,58
Imi dhe pinguini ,61
Loja me gishta ,63
Imi dhe ISH-ja ,65

Faza IV

Cacërime,68
Qaramant ,69
Ditë më ditë ,71
Gjyshja fjalxheshë,72
Imi e banana ,74
Blë-të e lmit ,77
Fiesë sportisti ,78
Mësim vizatimi ,79
Qortim motor ,81
Kicat kicilojnë ,82
Im maratoni ,84
Kalshet dhe shpezët,85
Ngjarja në piknik,87
Vesi për dënim,89
Babi s' është TYTY!,91
Në prag të përvjetorit ,92
Fjalë me peshë ,94
